

## RELACION TEKNIK

### **Objekti: PERFUNDIMI I PUNIMEVE PER SISTEMIM I LUMIT TE BUCIMASIT DHE REHABILITIM I INFRASTRUKTURES RRUGORE**

Segmenti i rruges i cili trajtorhet nga ky projekt fillon ne kryqezimin e rruges se Gurras - Bucimas dhe perfundon ne kryqezimin e rruges Pogradec – Tushemisht.

Ky objekt ishte pjese e investimeve te vitit 2023 qe realizoi Bashkia Pogradec. Gjate zbatimit te punimeve ne objekt rezultoi se volume e punimeve te parashikuara ne projekt-preventivin fillestar kishin nevojë per rishikime. Sipermaresi i punimeve e mbikqyresi i punimeve hartuan projekt-preventivin e rishikuar te kontrates i cili u miratua nga ana e Bashkise Pogradec.

Per te realizuar me sukses investimin ne kete objekt duhet te shtohet fondi me nje vlere prej **15'995'027 lek me TVSH.**

Projekti shtese parashikon :

- **Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri – 8010 m2**
- **Shtrese pllaka betoni dekorative C 25/30 6 cm mbi shtrese rere / granili t=5 CM – 920 m2**

Ky projekt synon:

Krijimin e kushteve e parametrave per nje permiresim te kesaj zone ne drejtim te:

- Permiresimit te cilesise se jeteses
- Permiresimit te ambjentit
- Lehtesimin e levizjes se njerezve.

Per realizimin e projektit me zerat të mesiperm nevojitet nje fond prej **15,995,027 lek me TVSH.**

Investimi i kerkuar pervecse do të beje të mundur realizimin e objektit me gjithë elementet e tij, do te beje të mundur sistemimin ne nje zone te rendesishme me parametra bashkekohore dhe permiresim të kushteve të jeteses dhe të ambjentit ne teresi duke rritur cilesine e jeteses dhe permiresimin e qarkullimit te mjeteve te transportit , parkimet e duke lehtesuar levizjen e njerezve.

Ky investim eshte i domosdoshme per realizimin e nje investimi efektiv dhe jetegjate.

Hartoi: Ing. Klajdi ILO

Ing. Arsel LICKOLLARI